



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARE

Lindita NIKOLLA

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2021**

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;
- Duke vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar e bankar;
- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare,

Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në drejtim të:

Kryerjes së simulimeve teknike për raportimin dhe ngarkimin e saktë në sistemin e Agjencisë të skedarëve për simulim/kompensim.

Përmirësimin të kapaciteteve monitoruese dhe vlerësuese të Agjencisë në vazhdimësi për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondit të kompensimit të depozitave në banka.

Intensifikimit të marrëdhënieve me institucionet e rritjes së sigurisë financiare, me qëllim sigurimin e shpejtë të likuiditetit ose plotësimin e fondeve të Agjencisë në rast të një ngjarje sigurimi.

Kryerjen e testeve periodike për të matur nivelin e njohurive që kanë punonjësit lidhur me skemën e sigurimit të depozitave duke identifikuar hapësirat për përmirësim.

Kryerjen e veprimtarive promovuese, me qëllim informimin dhe edukimin e publikut për përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave.

Kuvendi rekomandon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave për vitin 2022 të përmirësojë punën në këto drejtime:

1. Të vazhdojë kryerjen e simulimeve teknike me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave në funksion të përmirësimit të raportimit të saktë dhe në kohë nga subjektet anëtare në Agjenci në rast ngjarje sigurimi.

2. Të përmirësojë kapacitetet e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në Agjenci, në funksion të automatizimit të administrimit të procesit të kompensimit.

3. Të organizojë ushtrimet e simulimit, trajnimet e posaçme dhe të vlerësojë kriteret e përgjithshme dhe teknike të bankave agjente të përzgjedhura, me qëllim përmbushjen me sukses të detyrimeve të tyre në rast ngjarjeje sigurimi.

4. Të përmirësojë procedurat operacionale të Agjencisë për parandalimin dhe adresimin e rreziqeve që mund të shkaktohen nga situata, të cilat mund të ndërpresin vijueshmërinë e veprimtarisë së institucionit.

5. Të identifikojë ndryshimet e mundshme ligjore dhe nënligjore për sigurimin e depozitave, me qëllim përputhshmërinë e kuadrit ligjor dhe rregullativ të juridiksionit vendas me Direktivën e Bashkimit Europian 2014/49/EU “Për skemat e sigurimit të depozitave”.

6. Të vijojë bashkëpunimin me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare dhe partnerët ndërkombëtare në drejtim të rritjes së aftësisë paguese të Agjencisë në rast ngjarje sigurimi.

Miratuar në datën 12.5.2022